



REPUBLIKA E KOSOVËS		REPUBLIKA E KOSOVËS	
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË DEGA NË RAHOVEC			
29.05.2023			
Nr.	Br.	Shtojce	Prilog

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:225404
Datë: 16.05.2023
Numri i dokumentit: 04283694

Ka. nr. 183/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në Kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Azra Cakolli kryetare e Kolegjit, Ramiz Kuqi dhe Skender Çoçaj anëtarë, në çështjen kundërvajtëse ndaj të pandehurës Subjektit afarist - Personit Juridik “Jazi” SHPK, Njësia 1, në fshatin Rogovë – Komuna e Gjakovës, me Person përgjegjës – Bekim Gashi, nga fshati Rogovë, për kundërvajtje nga neni 4 të Ligjit Nr. 2004/05 për Tregti me Naftë dhe Derivate të Naftës në Kosovë, e sanksionuar sipas nenit 14 par. 1 të Ligjit Nr. 03/L-138 për Ndryshimin dhe Plotësim të Ligjit Nr. 2004/05 për Tregti me Naftë dhe Derivate të Naftës në Kosovë, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga Bekim Gashi pronari i të pandehurës “Jazi” SHPK, Njësia 1, në fshatin Rogovë – Komuna e Gjakovës, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, K. nr. 04-585/2021, të datës 16.01.2023, në bazë të nenit 55 par. 3 dhe nenit 78, konform të nenit 143 par. 1 dhe par. 3 të Ligjit për Kundërvajtje, Nr. 05/L-087, më datë 15.05.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Duke vendosur sipas ankesës së paraqitur nga e pandehura Subjekti afarist - Personi Juridik “Jazi” SHPK, Njësia 1, në fshatin Rogovë – Komuna e Gjakovës, me pronarë Bekim Gashi, **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, K.nr. 04-585/2021, i datës 16.01.2023, **sa i përket cilësimit juridik, konform nenit 5 të LK-së**, (ligji më i favorshëm) vepra kundërvajtëse për të cilën Subjekti Ekonomik – Person Juridik “Jazi” SHPK, Njësia 1, në fshatin Rogovë – Komuna e Gjakovës, është shpall përgjegjëse cilësohet si vepër kundërvajtëse nga neni 6 par. 1 dhe par. 2 pika 2.7 sanksionuar sipas nenit 19 par. 2 pika 2.1 të Ligjit Nr. 08/L-018 për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtrishme, si **dhe sa i përket gjobës së shqiptuar**, ashtu që i shqiptohet dënimi me gjobë në shumë prej **5000(pesëmijë)€**, të cilën ka për ta paguar në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e caktuar e njëjta do të arkëtohet me dhunë sipas Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

Në pjesën tjetër aktgjykimi mbetet i njëjtë.

Nga një kopje të këtij aktgjykimi duhet dorëzuar palëve.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec – Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, duke vendosur sipas Kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse të ushtruar nga ana e MINT-së - Inspektorati i Tregut, në Prishtinë, me numër të Ref. INS 19/21 të datës 27.08.2021, dhe me numër të Protokollit 6233, me aktgjykim K.nr. 04-585/2021, të datës 16.01.2023, të pandehurën Subjektin afarist “Jazi” SHPK, Njësia 1, në fshatin Rogovë – Komuna e Gjakovës, si person juridik, e ka shpallë përgjegjëse sepse:

-me datë **22.07.2021**, gjatë inspektimit të kryer nga ana e Inspektoratit të Tregut të MTI-së, të Subjektit afarist “Jazi” SHPK, me numër të biznesit 811127093, është konstatuar në Procesverbalin e Inspektimit Nr. 19/000667, se ushtron veprimtarin ekonomike pa Licencë të Organit kompetent për shitje me pakicë të GLN-së, me ç veprim ka kryer kundërvajtje nga neni 4 të Ligjit Nr. 2004/05 për Tregti me Naftë dhe Derivate të Naftës në Kosovë, e sanksionuar sipas nenit 14 par. 1 të Ligjit Nr. 03/L-138 për Ndryshimin dhe Plotësim të Ligjit Nr. 2004/05 për Tregti me Naftë dhe Derivate të Naftës në Kosovë, e i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej **10.000(dhjetëmijë)€**, të cilën obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën gjoba e shqiptuar do të arkëtohet me dhunë sipas dispozitave të Ligjit për Procedurën Përmbartimore.

Me të njëjtin aktgjykim është obliguar e pandehura që në emër të paushallit gjyqësor – shpenzimeve gjyqësore të paguaj shumën prej **5(pesë)€**, në aftë të njëjtë sikurse edhe gjobën.

Kundër aktgjykimit ka ushtruar ankesë i pandehuri “Jazi” SHPK, Njësia 1, në fshatin Rogovë – Komuna e Gjakovës, pronari Bekim Gashi, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kundërvajtëse, vërtetimit të gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike si dhe vendimit mbi dënimin, në të cilën në mes të tjerash thekson se: gjykata nuk ka pas parasysh se subjekti në fjalë ka bërë Kërkesë në Ministrinë përkatëse për marjen e Licencës për ushtrimin e veprimtarisë së shitjes me pakicë të GLN-së, por Ministria nuk i është përgjigjur me kohë. Gjykata ka bërë shkelje pasi që nuk ka përfillur procedurën kundërvajtëse. Për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike ka ardhur edhe te aplikimi i gabuar i së drejtës materiale në dëm të pandehurës. Po ashtu dënimi i shqiptuar nuk i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së të pandehurës.

I propozon Gjykatës së Apelit - Divizioni i Kundërvajtjes, që ankesa të aprovohet dhe aktgjykimi i ankimuar të Ndryshohet ashtu që i njëjti lirohet nga përgjegjësia dhe dënimi i shqiptuar ose të Anulohet dhe çështjen ta kthen në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Kolegji i kësaj Gjykate duke i vlerësuar thëniet në ankesën e paraqitur, aktgjykimin e goditur, si dhe në bazë të mbrojtjes së pronarit të pandehurës Bekim Gashit, të dhënë pranë Gjykatës së shkallës së parë, në Procesverbal të datës 16.01.2023, i cili ka deklaruar se nuk ka licencë për shitje me pakicë të GLN-së, duke e pranuar kundërvajtjen duke sqaruar se ka ushtruar Kërkesë në Ministrinë përkatëse por nuk i është dhënë Licenca, duke kërkuar nga gjykata ti shqipton një dënim më të butë pasi që tani nuk janë duke operuar në treg me GLN-së, në bazë të Procesverbalit të Inspektimit Nr. Nr. 19/000667 të datës 22.07.2021, Certifikatës së ARBK-së, ku shihet se Bekim Gashi, është pronar “Jazi” SHPK, si dhe në bazë të shkresave tjera të lëndës, padyshim se e ka vërtetuar gjendjen faktike se i pandehuri ka kryer vepër kundërvajtëse sipas Ligjit në fuqi,

nga neni 6 par. 2 pika 2.7 sanksionuar sipas nenit 19 par. 1 dhe par. 2 pika 2.1 të Ligjit Nr. 08/L-018 për Tregti me Produktet të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtrishëme, të cilën Gjykata e Apelit bazuar në nenin 5 të LK-së, e ka ri - kualifikuar pasi që Ligji i cili është tani në fuqi është më i favorshëm për të pandehurin, ku parashihet dënimi me gjobë për personin Juridik prej **5000€ - 15.000€**, po ashtu të Përkufizimet në Ligjin Nr. 08/L-018 për Tregti me Produktet të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtrishëme, në nenin 3 par. 1 pika 1.6. decidivisht thotë citim **“karburantet e naftës** - karburantet e përfituara nga nafta, siç janë dizel, benzina, karburanti në fushën e aviacionit, **gazi i lëngëzuar i naftës**, (GLN) gazoili, vaji i rëndë për nxehje, vajguri, koksi i naftës dhe produktet e tjera për djegie” fund i citatit, që do të thotë se GLN është Karburant i naftës, andaj për këtë kundërvajtje mban përgjegjësi dhe në këtë drejtim nuk ka bazë ligjore për anulimin e aktgjykimit të ankimuar ashtu si që i pandehuri pretendon në ankesë.

Si rrjedhojë e të cekurave më lartë, Kolegji e NDRYSHOJ aktgjykimin e goditur, vetëm sa i përket cilësimit juridik të kundërvajtjes dhe lartësisë së gjobës së shqiptuar, ashtu që vepra kundërvajtëse për të cilën i pandehuri është shpall përgjegjës - cilësohet si vepër kundërvajtëse nga neni 6 par. 1 dhe par. 7 sanksionuar sipas nenit 19 par. 2 pika 2.1 të Ligjit Nr. 08/L-018 për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtrishme dhe Personit Juridik “Jazi” SHPK, i shqiptoi dënim me gjobë në shumë prej 5000(pesëmijë)€, (minimumin e paraparë me ligjin e ri), duke marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit, peshën, rrezikshmërinë, pasojat e veprës së kryer, duke konsideruar se me gjobën e shqiptuar tani do të arrihet qëllimi i ndëshkimit ashtu që i pandehuri në të ardhmen të mos kryej vepra kundërvajtëse të njëjta apo të ngjashme.

Në vështrim të nenit 143 par. 1 dhe par. 3 të LK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform të nenit 143 par.1 dhe par. 3 të LK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi nuk është e lejuar ankesa.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

Ka. nr. 183/2023, me datë 15.05.2023,

KRYETARIA KOLEGJIT,
Azra Cakolli

